



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.62, datë 17.05.2024

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Genti Xholi, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Zoti Genti Xholi do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për një periudhë deri në tre muaj.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Genti Xholi do të paguhet me pagën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Genti Xholi, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 17.05.2024.



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Arta Mandro

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ANËTAR
Nurizhan Sciti

ANËTAR
Ledina Riza

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaq

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj



[Faint handwritten text at the bottom of the page, possibly a signature or date, written in blue ink.]